



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.100/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor, Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterit në hapsirë publike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 03.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë, ZL.Anr.100/2017, të datës 29.09.2017, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 1500 (*njëmij e pesëqind*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

Me datën 29.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendon se me datën 29.09.2017, rreth orës 08:00 nga qendra në rrugën e Reçakut, përkatësisht në trotuar janë vendosur posterat e kandidatit për kryetar të Kuvendit Komunal në Ferizaj Muharrem Svarça nga radhët e subjektit politik LDK.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 pika b), të LPZ-së, të dispozitës së nenit 4.1 pikëa b të Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së.

Nga pretendimet e cekura ankimore, PZAP-it i ka kërkuar që subjektit politik LDK ti shqiptohen masa e sanksionit në mbështetje të nenit 3.3.2 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it (Nr.01/2012).

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një (1) fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të datës 02.09.2017, ka pranuar shkeljen e pretenduar duke theksuar se posterit i kandidatit për kryetar të Komunës së Ferizajit është vendosur në një objekt lëvizës, i njëjti shërben posaqërisht për reklamime të tilla dhe po ashtu vendi ku është vendosur posterit është pronë private. Më tutje ka shtuar se, pronari i lokalit duke qenë mbështetës i kandidatit në fjalë, ka lejuar vullnetarët e shtabit lokal që të vendosin posterat. Po ashtu PZAP-in, e ka njoftuar se ka ndërruar masa përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur dy fotografi nga vendi ku janë larguar pllakatat.

Paneli, pasi që vlerësoj ankesën konstatoi se :

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për kryetar për Kuvendin Komunal në Ferizaj, Muharrem Svarça nga radhët e subjektit politik LDK, është ngjitur në një pano, në trotuar pra në vendë publik, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli vërteton se nga prova e ofruar shihet qartë se nga ana e subjektit politik LDK, është shkëlur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posteri i kandidatit për kryetar për Kuvendin Komunal në Ferizaj, nga subjektit politik i LDK-së, është vendosur në vende publike përkatësisht në një pano e gjendur në trotuar. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë subjekti politik LDK, në përgjigjen në ankesë të datës 25.09.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, morri parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politikë Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti posteri i kandidatit të këtij subjekti politik është vendosur në hapësirë dhe në rrugë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e morri edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë hequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL.Anr. 100/2017 më datën 03.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.